



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 443/9 prot.

Tiranë, më 28.12.2018

VENDIM

Nr.101, datë 28.12.2018

PËR

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 71, DATË 06.07.2018**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit Nr. 71, datë 06.07.2018, “Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nëpërmjet kërkesës së aplikantes Velisjana Sherifi, protokolluar me nr. 443 prot., datë 14.05.2018”, në Bashkinë Vlorë.

KONSTATOVA SE:

Nëpërmjet kërkesës/informacionit të regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me nr. 443 prot., datë 14.05.2018, kandidatja ******, ka ngritur pretendimet se, në fazën e dytë të konkurrimit (*intervista e strukturuar me gojë*), për pozicionin “*Specialist personeli*”, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Bashkia Vlorë, nuk është zhvilluar në përputhje me kërkesat e ligjit, duke renditur disa shkelje të elementëve proceduralë të Komisionit të Përhershëm të Pranimit dhe Njesisë Përgjegjëse pranë kësaj bashkie.

Pas hetimit administrativ të këtij rasti, Komisioneri ka përmbyllur procesin me Vendimin Nr. 71, datë 06.07.2018, “Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nëpërmjet kërkesës së aplikantes ******, protokolluar me nr. 443 prot., datë 14.05.2018”, në të cilin është vendosur:

*“1. Të rregullohet ligjshmëria në administrimin e shërbimit civil nga ana e njësisë përgjegjëse në Bashkinë Vlorë, duke anuluar aktin e emërimit nr. 3 (3494 prot.), datë 07.05.2018, “Akt emërimi si nëpunës civil në periudhë prove”, të punonjësës *****, në pozicionin “Specialist personeli”, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të Bashkinë Vlorë.*

2. Komisioni i Përhershëm i Pranimit, i ngritur për të plotësuar pozicionin e punës objekt shqyrtimi, të përsërisë procedurën e intervistës së strukturuar me gojë, duke pasur parasysh kërkesat e Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” dhe Udhëzimit nr. 02, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike, sidomos në momentin e informimit të kandidatëve për të drejtën e regjistrimit të intervistës së strukturuar me gojë, si dhe në lidhje me vijimësinë e procesit në fazat përkatëse të tij.

3. Komisioni i Përhershëm i Pranimit, pasi të kenë kaluar afatet e ankimit si dhe pasi të jenë ezauruar të drejtat e ankimit të pjesëmarrësve në konkurrim, të njoftojë njësinë përgjegjëse në Bashkinë Vlorë, për rezultatin e fituesit, për të mundësuar vijimin e procesit me procedurat e mëtejshme.

4. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 10 ditë nga marrja dijani për këtë vendim.”

Me kalimin e afatit procedural të lënë për zbatimin e rekomandimeve të Vendimit paralajmërues të Komisionerit Nr. 71, datë 06.07.2018, Bashkia Vlorë ka informuar Komisionerin për masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.

Konkretisht, në zbatim të nenit 114, të Kodit të Procedurave Administrative dhe pikës 1 të dispozitivit të Vendimit Nr. 71, datë 06.07.2018, të Komisionerit, Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Vlorë me Aktin nr. 3/1, datë 10.07.2018, “Për anulimin e emërimit nr. 3, datë 07.05.2018”, ka anuluar aktin nr. 3 (3494 prot.) datë 07.05.2018, “Akt emërimi si nëpunës civil në periudhë prove”, të punonjësës *****.

Në zbatim të pikës 2, të vendimit paralajmërues, njësia përgjegjëse e ka përsëritur edhe një herë procedurën e intervistës së strukturuar me gojë, duke njoftuar individualisht tre kandidatët e kualifikuar për të marrë pjesë në këtë procedurë (*përfshi edhe kërkuosen ******) në datën 12.07.2018. Njoftimi përmban datën, orën dhe vendin e zhvillimit të intervistës.

Në datën 17.07.2018 (*data e zhvillimit të intervistës së strukturuar me gojë*), Komiteti i Përhershëm i Pranimit ka mbajtur një procesverbal në lidhje me prezencën e kandidatëve të kualifikuar me të paktën 30 pikë, nga i cili rezulton se kandidatet

***** dhe ***** nuk janë paraqitur. Në këtë fazë të konkurrimit ka marrë pjesë vetëm kandidatja *****.

Sipas dokumentacionit që materializon zhvillimin e kësaj procedure, rezulton se nga ana e njësisë përgjegjëse të Bashkisë Vlorë janë korrigjuar të gjitha mangësitë e evidentuara nga Komisioneri në procedurën e mëparshme të intervistës së strukturuar me gojë të zhvilluar në datën 20.04.2018. Konkretisht:

- Kandidatja ***** është njohur me mundësinë për të regjistruar me zë intervistën e strukturuar me gojë, duke nënshkruar deklaratën përkatëse.
- Në dosjen e testimit është depozituar lista e pyetjeve të intervistës së strukturuar me gojë të hartuar nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit.
- Vendimi i Komitetit të Përhershëm të Pranimit për rezultatin përfundimtar të procedurës së pranimit në kategorinë ekzekutive në shërbimin civil për grupin e pozicioneve “*Specialist Personeli*” i është njoftuar njësisë së burimeve njerëzore më datën 17.07.2018.

Në përfundim të këtij procesi, njësia përgjegjëse, me aktin e emërimit nr. 7, datë 17.07.2018, ka vendosur emërimin e ***** në pozicionin “*Specialist Personeli*” në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Vlorë.

Për sa u parashtrua më sipër, rezulton se nga ana e institucionit, Bashkia Vlorë, janë zbatuar rekomandimet e lëna në Vendimin paralajmëruar Nr. 71, datë 06.07.2018, “*Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nëpërmjet kërkesës së aplikantes Velisjana Sherifi, protokolluar me nr. 443 prot., datë 14.05.2018*”.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “*Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” dhe Rregulloren, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 71, datë 06.07.2018, “*Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nëpërmjet kërkesës së aplikantes ***** , protokolluar me nr. 443 prot., datë 14.05.2018*”.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e subjektit të inspektuar Bashkia Vlorë, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit Nr. 71, datë 06.07.2018.

3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni Bashkia Vlorë, dhe ankuesja *****.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha